



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 51-të, të mbajtur më datë 01.09.2021 morri

VENDIM

Denoncimi / kërkesa me numër 12-4761 / 1 nga 10.10.2019, dorëzuar nga parashtruesi nga -----
--- nga -----, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndën me numër 12-4761 të vitit 2019.

Lënda me numër 12 -4761 e vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetërorë, me arsyetim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim- në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4761 të vitit 2020, e formuar pas denoncimit me numër 12 - 476/1 të datës 10.10.2019, e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) nga parashtrues i njohur, ----- nga -----.

me kërkesën e dorëzuar kërkohet revizion i lëndës pas së cilës veproi KSHPK -dhe për veprimin e saj kompetent e informoi parashtruesin e denoncimit më 23.03.2012, por parashtruesi kërkon që kjo përbërje e KSHPK -së të veprojë përsëri në rastin e tij dhe të rishqyrtojë rastin.

Në shtojcë është dorëzuar njoftim me numër 12-858 / 3 nga 23.03.2012 të cilin KSHPK-ja ia ka dorëzuar parashtruesit, duke e informuar se KSHPK-ja, pasi ka vlerësuar të gjitha pohimet në denoncim dhe dokumentacionin e bashkangjitur, në seancë ka konstatuar se nuk ka elemente në veprim e saj kompetent sipas lëndës së formuar pas denoncimit të dorëzuar. Në të njëjtën kohë, përveç kërkesës, është dorëzuar edhe aktvendim për trashëgimtarët ligjorë të miratuar nga Gjykata Komunale Shkup I Shkup më 26.01.1995, të cilin kjo gjykatë e ka miratuar duke vendosur për një procedurë prove të të ndjerit -----.

Nga inspektimi i realizuar në kërkesën e dorëzuar dhe shtojcat ndaj të njëjtës, KSHPK konstatoi se bëhet fjalë për denoncim të dorëzuar në KSHPK në të cilin janë shprehur dyshimet për abuzime dhe veprime korruptive në lëndë dhe procedurë para Gjykatës Themelore Shkup II në Shkup. me numër ----- dhe dyshime të caktuara që i referohen kryetarit të komunës dhe zyrtarëve të tjerë nga komuna -----

KSHPK-ja veptoi sipas denoncimit të dorëzuar dhe në seancë konstatoti se nuk ka elemente për veprimin e tij kompetent në lëndën e formuar pas denoncimit dhe për veprimin e tij kompetent e informoi parashtruesin me njoftim të regjistruar në arkiv me numër-----.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së dorëzuar, KSHPK -ja arriti në përfundimin se lidhur me pohimet e denoncuar, KSHPK -ja tashmë ka vepruar dhe ka miratuar vendim nga kompetenca e saj, dhe veprimet e denoncuar nuk janë në kompetencën e KSHPK -së, por në kompetencën e organeve të tjerë. Nga këtu, KSHPK vlerëson se nuk ka elementë për veprim të mëtejshëm në rastin e lëndës, procedura për lëndën të refuzohet ndërsa lënda të mbyllet dhe arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën këtij vendimi.

KOMISIONI SHTEΤΕΡΟΡ
ΠΕΡ ΠΑΡΑΝΔΑΛΙΜΙΝ Ε ΚΟΡΡΥΠΣΙΟΝΙΤ
KRYETAR
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:

- Arkivi
- Parashtruesi

Punoi: J.C.

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

